

## **VENDIM**

**Nr. 38, date 16.1.2003**

### **PER MIRATIMIN E NORMAVE, TE RREGULLAVE DHE KUSHTEVE TE PROJEKTIMIT DHE TE NDERTIMIT, TE PRODHIMIT DHE RUAJTJES SE NXEHTESISE NE NDERTESA**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 5 te ligjit nr. 8937, date 12.9.2002 "Per ruajtjen e nxehtesise ne ndertesa", me propozimin e Ministrit te Industrise dhe te Energjetikes, Keshilli i Ministrave

#### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e normave, te rregullave dhe kushteve te projektimit dhe te ndertimit, te prodhimit dhe ruajtjes se nxehtesise ne ndertesa, qe i bashkelidhen ketij vendimi.
2. Personat, fizike ose juridike, qe hartojne projekte per ndertimin e ohjekteve, publike dhe private, te zbatojne normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe te ndertimit, te prodhimit dhe ruajtjes se nxehtesise ne ndertesa, te miratuara sipas ketij vendimi.
3. KRRT-te e bashkive dhe te qarqeve te miratojne lejet e ndertimit, vetem pasi te jene plotesuar normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe te ndertimit, te prodhimit dhe ruajtjes se nxehtesise ne ndertesa, te percaktuara ne kete vendim.
4. Ngarkohen Ministria e Industrise dhe e Energjetikes, Ministria e Rregullimit te Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.